



# STIKK

SHOQATA PËR TEKNOLOGJI TË INFORMACIONIT  
DHE TË KOMUNIKIMIT TË KOSOVËS  
KOSOVO ASSOCIATION OF INFORMATION  
AND COMMUNICATION TECHNOLOGY

## BAROMETRI I TI PËR KOSOVË 2018

NËNTOR 2018

Projekti Youth employment Through Digitalisation and Export Promotion përkrahët nga:



---

# BAROMETRI I TI PËR KOSOVË 2018 RAPORTI FINAL

NËNTOR 2018  
PRISHTINË, KOSOVË

ZBATUAR NGA:



AUTORË TË RAPORTIT: KUJTIM KOCI & RINA BULLIQI

# TABELA E PËRMBAJTJES

---

LISTA E TABLAVE DHE FIGURAVE .....	02
TË GJETURAT KRYESORE .....	04
Të gjeturat kryesore .....	05
HYRJE.....	06
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT .....	08
GJETJET E ITIB KOSOVO 2018.....	12
Trendet në industri .....	13
Eksporti i shërbimeve dhe produkteve të TI.....	22
Performanca financiare .....	28
Burimet njerëzore.....	32

# LISTA E TABELAVE DHE FIGURAVE

Figura 1: Ku ndodhet kompania juaj? (N=36).....	9
Figura 2: Cilli lloj i strukturës pronësore vlen për kompaninë tuaj? (N=31).....	10
Figura 3: Kompania juaj është pjesë e: (N=36) .....	10
Figura 4: Cilat produkte dhe/apo shërbime i ofron kompania juaj?? (N=36) .....	13
Figura 5: Çfarë lloje të sistemeve dhe platformave operative përdorni? (N=36).....	13
Figura 6: Cilat teknologji i keni përdorur për të prodhuar shërbime/zhvilluar produkte? (N=35) .....	14
Tabela 1: Cilat gjuhë programuese dhe “developing tools” i përdorni? (N=36).....	15
Tabela 2 Çfarë teknologji të databazave përdorni? (N=36) .....	16
Figura 7: Cilat nga standardet e cilësisë të cekura më poshtë, i’u është kërkuar kompanisë suaj që t’i përmbajë? (N=36).....	17
Figura 8: Cila është arsyeja kryesore që kompania juaj ka marrë një standard të cilësisë? (N=36) .....	17
Figura 9: Cilat çertifikime të mëposhtme vlejné për punëtorët tuaj? (N=36).....	18
Figura 10: Cili është tregu primar i kompanisë suaj? .....	18
Figura 11: Cilat janë avantazhet konkurruese themelore të kompanisë suaj në Kosovë? (N=36).....	19
Figura 12: A ofron kompania juaj shërbime për organizata/klientë ndërkombëtar në Kosovë? (N=35) .....	20
Tabela 3 Në cilët sektorë operon kompania juaj në Kosovë? (N=36).....	21
Figura 13: A ndërmerr kompania juaj aktivitete eksportuese? (N=35) .....	22
Figura 14: Me çfarë lloji të bizneseve apo organizatave punon kompania juaj, brenda tregut eksportues? (N=29) .....	22

Figura 15: Ju lutem vlerësoni tregjet potenciale për eksport, të listuara më poshtë: (N=36) .....	23
Figura 16: Cilat janë avantazhet themelore të kompanisë suaj në tregjet ndërkombëtare? (N=29) .....	24
Figura 17: Cilat nga gjuhët e përmendura më poshtë njihen nga punonjësit e juaj? (N=36) .....	25
Figura 18: Si e zhvilloni biznesin në tregje eksportuese? (N=30) .....	25
Figura 19: Ju lutem vlerësoni sfidat e mëposhtme në biznes me tregje eksportuese:.....	26
Figura 20: Cilat janë të ardhurat tuaja vjetore (në EURO)? .....	28
Figura 21: Sa ishte eksporti në vitin...? (N=33) .....	29
Tabela 4: Në cilin nga sektorët e mëposhtëm jeni të angazhuar aktualisht, në tregje eksportuese?.....	30
Tabela 5: Ne cilat tregje horizontale i ofroni produktet dhe/apo shërbimet e mëposhtme të IT? (N=36) .....	31
Figura 22: Ju lutem na tregoni numrin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve (nëse keni pasur) për vitet në vijim. (N=29) .....	32
Figura 23: Sa është përqindja e ndërrimit të punonjësve tuaj (turnover rate)?.....	33
Figura 24: Sa kohë ju duhet për të zëvendësuar punëtorët që e lënë punën?.....	33
Figura 25: Sa kanë qenë të ardhurat mujore mesatare(sipas kontratës së punës), për pozitën e mëposhtme? (N=36) .....	33
Figura 26: Si pritni këto ndryshime në vitin e ardhshëm? (N=36).....	34
Figura 27: Duke i konsideruar rrethanat aktuale, cili është ndikimi i faktorëve në vijim, në zhvillimin e biznesit tuaj? (N=36).....	34
Figura 28: A po ndikon ikja e trurit (brain drain), në biznesin tuaj? (N=36) .....	35
Figura 29: A përballet Kosova me mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar? (N=36).....	35

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE



Ky studim u realizua nga Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit (STIKK) me qëllim të mbledhjes së të dhënave mbi funksionimin dhe zhvillimin e sektorit të TI në Kosovë. Ky hulumtim është vazhdim i “Barometri i TI”, i cili kryhet çdo vit nga STIKK.

Për të mbledhur të dhëna për këtë studim u përdor një mostër prej 36 kompanive të TI që veprojnë në Kosovë. Hulumtimi u zhvillua nga shtatori deri në nëntor të vitit 2018.

## TË GJETURAT KRYESORE

Sektori i TIK aktualisht konsiderohet një nga sektorët e paktë në Kosovë me bilanc pozitiv tregtar. Ky fakt është vërtetuar edhe nga gjetjet e këtij raporti, sipas të cilit tri nga katër kompani të intervistuar të TIK në Kosovë (74%) eksportojnë produktet apo shërbimet e tyre. Kjo cilësohet si rritje e konsiderueshme nga viti i kaluar kur një pjesë më e vogël prej 58 përqind e kompanive kanë deklaruar se kanë kryer aktivitete eksportuese. Kompanitë e sektorit të TI besojnë se suksesi i tyre në tregjet eksportuese mund të jetë falë përparësive të tyre në anën e cilësisë (90%), njohurive teknike (83%) dhe çmimeve (76%).

Shtetet/rajonet e botës me potencialin më të lartë të eksportit janë Gjermania (44%), Amerika Veriore (42%) dhe Zvicra (24%). Kompanitë e Teknologjisë së Informacionit në Kosovë janë kryesisht të angazhuara në tregjet e eksportit duke ofruar shërbime dhe produkte në sektorin e shërbimeve të TI dhe shërbimeve të jashtme (outsourcing) (56%) dhe në sektorin e Teknologjisë (41%).

Rezultatet e Barometrit të TI të këtij viti tregojnë tendenca pozitive në aspektin e të ardhurave dhe pagave në industrinë e TI. Kompanitë presin që të gjenerojnë të ardhura mesatare prej 912,045.00€ në vitin 2018, më shumë se dyfishi i mesatares prej 435,990.00€ të raportuar në vitin 2017. Pagat mujore për profesionistët e TI kanë pasur gjithashtu rritje të qëndrueshme gjatë dy viteve të fundit. Mesatarisht, pagat për profesionet e TI janë rritur me 4 përqind. Menaxherët e Zhvillimit të Biznesit (9%), Zhvilluesit (8%) dhe Administratorët (8%) kanë pare rritjen më të madhe në këtë drejtim.

Pavarësisht rritjes së numrit mesatar të punëtorëve nga 16 në vitin 2017 në 21 në vitin 2018, industria e TI përballet me vështirësi në mbajtjen e punëtorëve të tyre, duke qenë se më shumë se gjysma e kompanive kanë pasur normë të qarkullimit të punëtorëve prej 10 deri 25 përqind. Bazuar në Barometrin e TI të vitit 2017, shumica dërrmuese e kompanive të TI (77%) raportuan normën e qarkullimit të punëtorëve prej më pak se 10 përqind. Megjithatë, shumica e kompanive (56%) pohojnë se janë në gjendje të zëvendësojnë punëtorët ekzistues brenda tre muajve.

Trendi pozitiv në rritje i numrit mesatar të punëtorëve dhe pagave të tyre pritet të vazhdoj në vitin 2019. Njëzet e pesë përqind e kompanive të intervistuar të TI parashikojnë një rritje prej 50 përqind në numrin e punëtorëve të tyre ndërsa 42 përqind e kompanive besojnë që numri i punëtorëve do të rritet për 25 përqind. Përveç kësaj, më shumë se gjysma e kompanive të TI (55%) besojnë se do të ketë një rritje prej 10 përqind në pagat e specialistëve e TI dhe një tjetër 35 përqind besojnë se specialistët e TI do të përfitojnë rritjen e pagave prej 25 përqind apo më shumë. Përkundër pritjeve të rritjes së punëtorëve në vitin 2019, kompanitë e TI ankohen për mungesën e fuqisë së aftë dhe kualifikuar punëtore (78%) dhe 92 përqind e të intervistuarve pohojnë se bizneset e tyre janë prekur nga ikja e trurit (brain drain).



HYRJE



Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) ka filluar të luaj rol kryesor në rritjen ekonomike të Kosovës, pasi që është shndërruar në vend destinacion të kompanive rajonale e ndërkombëtare të cilat kërkojnë shërbime të jashtme (outsourcing). Duke qenë sektor strategjik i vendit, institucionet qeveritare dhe institucionet ndërkombëtare të cilat veprojnë në Kosovë kanë dhënë mbështetjen e tyre ndaj zhvillimit të sektorit të TIK, duke siguruar fuqizimin e faktorëve kryesorë të sektorit.

---

Duke pasur parasysh që sektori i TI në Kosovë është relativisht i ri, me shumicë të kompanive të krijuara pas vitit 2000, po rritet e drejtohet shpejtë drejt trendeve globale të TIK. Themeluar në vitin 2008, STIKK qëndron si një ndër mbështetësit më të mëdhenj të sektorit dhe komunitetit të TIK, duke qenë se vazhdimisht bazon aktivitetin e tyre në promovimin e sektorit të TIK në Kosovë. Qëllimet e STIKK arrihen duke zbatuar aktivitete të bazuara në shtyllat kryesore të sektorit, si promovimi i eksportit, përmirësimi i përsosmërisë dhe cilësisë së kompanive, promovimi i investimeve, zhvillimi i tregut kombëtar dhe zhvillimi i politikave të promovimit të TI.

Në qershor të 2018, STIKK publikoi thirrjen për propozime për zbatimin e “Barometrit i TI 2018”. Qëllimi i Barometrit të TI është të:

- **Merrni një pasqyrë të zhvillimit të sektorit të TI në Kosovë;**
- **Mbështetja e kapaciteteve të eksportit të kompanive të TIK në Kosovë;**
- **Analizimi i trendeve të fundit të sektorit të TI;**

Me qëllim të grumbullimit të të dhënave mbi performancën dhe aktivitetet e kryera gjatë viteve të fundit, STIKK kontrakttoi UBO Consulting të kryej hulumtimin mbi sektorin e TI në Kosovë. Këto të dhëna bazike rreth kompanive të TIK në Kosovë kanë për qëllim të ofrojnë një pasqyrë të vlerës së tregut kombëtar të TIK, duke përfshirë kapacitetet eksportuese.

Ky Barometer i TI i Evropës Juglindore (SEE ITIB) për Kosovë është kryer që nga vitit 2014, mbështetur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ). SEE ITIB Kosova 2018 përqëndrohet në hulumtimin e çështjeve të mëposhtme lidhur me sektorin e TI në Kosovë:

- **Vështrim i përgjithshëm mbi zhvillimin e TI në Kosovë;**
- **Analiza krahasuese;**
- **Trendet e fundit të eksportit midis vendeve të synuara (potenciali eksportues, aktivitetet eksportuese, barrierat e eksportit);**
- **Analizimi i burimeve njerëzore;**
- **Analizë kualitative mbi trendet e fundit në sektorin e TI.**

# METODOLOGIA E HULLUMTIMIT



“Barometri i TI 2018” është kryer duke përdorur teknikën e intervistimit personal të ndihmuar përmes kompjuterit (CAPI). Duke pasur parasysh shpërndarjen gjeografike të kompanive të TI në Kosovë, shumica e intervistave të zhvilluara me kompani për “Barometrin e TI” 2018 u kryen në Prishtinë.

Për të ndërtuar mostrën, UBO Consulting kontaktoi listën e kompanive të TIK në Kosovë, të siguruar nga ekipi i STIKK. Mostra e përgjithshme përbëhet nga 36 intervista me kompani të TIK. Përveç kësaj, metodologjia e Barometrit të TI të këtij viti përfshiu edhe gjashtë intervista të thelluara me aktorë relevant në fushën e TI në Kosovë.

Duke marrë parasysh që pyetësi për “Barometrin e TI 2018” veç se ishte i hartuar dhe standardizuar, ai u përditësua nga ekipi i projekteve në STIKK dhe ekipi hulumtues i UBO Consulting, aty ku ishte e nevojshme. Pyetësi i miratuar, më pas u ngarkua në sistemin e menaxhimit të anketave, ASKIA, së bashku me planin e mostrës me kuota për secilin kriter.

Shumica e intervistave janë kryer në person duke përdorur teknikën CAPI (intervistimi personal me ndihmën e kompjuterit), ndërsa të tjerat janë kryer në internet. Puna në terren për këtë studim u zhvillua në mes të shtatorit dhe nëntorit të vitit 2018.

Shumica e kompanive të intervistuar të TI kanë lokacion kryesor Kosovën (32).






FIGURA 1: KU NDODHET KOMPANIA JUAJ? (N=36)

Për më tepër, 25 prej kompanive të intervistuar të TI në Kosovë kanë më shumë se 50 përqind pronësi vendore, pesë kompani janë degë e një kompanie të huaj dhe një kompani ka më shumë se 50 përqind pronësi të huaj.



**FIGURA 2: CILLI LLOJ I STRUKTURËS PRONËSORE VLEN PËR KOMPANINË TUAJ? (N=31)**

Tetëdhjetë e gjashtë përqind e kompanive të TI të intervistuar janë anëtare të STIKK. Sa për vende të tjera, gjashtë përqind e tyre janë anëtare të MASIT nga Maqedonia dhe tre përqind e tyre janë anëtare në BIT Alliance nga Bosnja dhe Hercegovina. Gjashtë përqind janë anëtare të shoqatave të tjera të TIK, ndërsa rreth 11 përqind nuk janë anëtare të asnjë shoqate.



**FIGURA 3: KOMPANIA JUAJ ËSHTË PJESË E: (N=36)**

Përveç hulumtimit kuantitativ, UBO Consulting ka realizuar gjashtë intervista të thelluara me aktorë relevant të sektorit të TI. Tabela e mëposhtme tregon listën e personave të intervistuar:

EMRI DHE MBIEMRI	INSTITUTI/ORGANIZATA/KOMPANIA
Bardh Kadiu	Coda Tech
Driton Hapçiu	CACTUS
Ilir Rexha	GIZ
Vigan Budima	Asseco
Agim Kukaj	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Bardh Ahmeti	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë





# TRENDET NË INDUSTRI

Shumica e kompanive të intervistuar të TI në Kosovë ofrojnë shërbime softuerike/IT (83%) dhe produkte softuerike (75%). Tre nga 10 kompani shesin produkte hardverike, ndërsa 11 për qind ofrojnë shërbime për produkte hardverike.




FIGURA 4: CILAT PRODUKTE DHE/APO SHËRBIME I OFRON KOMPANIA JUAJ?? (N=36)

Të gjeturat e këtij hulumtimi tregojnë që një kompani e zakonshme e TI në Kosovë përdorë mesatarisht katër sisteme operuese dhe platforma të ndryshme (OS). Në këtë drejtim, Windows vazhdon të jetë sistemi operues mbizotërues të cilin kompanitë e përdorin (92%). Tri nga katër kompani të TI në Kosovë gjithashtu përdorin Android (75%) dhe dy nga tri përdorin iOS (67%). Platformat dhe sistemet operative më së paku të njohura janë SUN OS – Solaris, i përdorur vetëm nga gjashtë përqind e kompanive dhe OS/400, i përdorur nga tre përqind e kompanive.





FIGURE 5: ÇFARË LLOJE TË SISTEMEVE DHE PLATFORMAVE OPERATIVE PËRDORNI? (N=36)

Ekziston një rritje në përqindjen e kompanive të cilat përdorin teknologjitë moderne për të ofruar shërbime dhe për të zhvilluar produkte. Përderisa në Barometrin e TI të vitit të kaluar, 44 përqind e kompanive pretendojnë të mos përdorin asnjë nga teknologjitë e paraqitura në grafën e mëposhtëm, kjo përqindje ka rënë në 31 përqind këtë vit. Ndryshimi më i madh në këtë drejtim prekë Inteligjencën Artificiale, duke qenë se vitin e kaluar, kjo teknologji nuk përdorej nga asnjë nga kompanitë e intervistuar, ndërsa këtë vit 37 përqind thanë që e përdorin atë. Teknologjia Blockchain pati një rritje në përdorim, duke shkuar nga 8% në 2017 në 14% në 2018. Tridhjetë përqind e kompanive të intervistuar përdorin teknologji të tjera, si Big Data.

Mbi 2/3 e kompanive të TI përdorin teknologji të reja në punën e tyre (69%), në dallim prej 15 përqind në vitin 2017.



**FIGURE 6: CILAT TEKNOLOGJI I KENI PËRDORUR PËR TË PRODHUAR SHËRBIME/ZHVILLUAR PRODUKTE? (N=35)**

Përderisa ka interesim dhe përparim në përfshirjen e teknologjive të reja në punë, pikëpamja e përgjithshme e palëve të intervistuar është se kompanitë kosovare janë ende në fillim të adaptimit të këtyre teknologjive. Sipas tyre, ka dika kompani të cilat merren me teknologji të reja në Kosovë, kryesisht duke eksperimentuar në teknologji si Realiteti i Zgjeruar (AR), Realiteti Virtual (VR), Inteligjenca Artificiale (AI) dhe Blockchain.

Të intervistuarit pretendojnë se me rritjen e kërkesës në tregun eksportues, kompanitë e TI përshtatin shërbimet e tyre me kërkesat. Momentalisht, kërkesat në tregjet eksportuese nuk janë të përqendruara në teknologji inovative, duke pasur parasysh që klientët ndërkombëtarë e kuptojnë se sektori i TI në Kosovë nuk ka maturuar ende dhe se shumica e kompanive në Kosovë janë të reja dhe ende të paeksportuara ndaj teknologjive të fundit.



Siç shihet nga tabela më poshtë, gjuhët e programimit dhe mjetet zhvillimore (development tools) më të njohura, vazhdojnë të jenë JavaScript (69%), Java (67%), HTML XML (64%) dhe PHP (58%). Tetë përqind thanë se nuk përdorin asnjë gjuhë programuese dhe mjete zhvillimi, në krahasim me 15 përqind nga viti 2017.

GJUHËT PROGRAMUESE	PËRQINDJA E PËRDORUESVE
JavaScript	69%
Java	67%
HTML, XML	64%
PHP	58%
.NET	56%
Python	39%
C++	39%
C	36%
Script Languages - others	33%
PL/SQL	33%
Basic – Visual Basic, VBA etc.	22%
Objective C	22%
SAS	11%
Delphi	6%
ESQL/C	6%
Macro Languages - others	6%
Pascal	6%
Perl	6%
Shell – C-Shell, K-Shell, Bourne-Shell	6%
Eiffel	3%
JCL	3%
VRML	3%
Yacc/lex	3%
Tjetër	19%
Nuk përdorim asnjë	8%


**TABELA 1: CILAT GJUHË PROGRAMUESE DHE “DEVELOPING TOOLS” I PËRDORNI? (N=36)**

Teknologjitë e databazës në SQL vazhdojnë të dominojnë tregun e TI në Kosovë. Rreth 69 përqind e kompanive të TI të intervistuar për këtë studim përdorin MS SQL Server si teknologji të tyre të databazës, pasuar nga 61 përqind të cilët përdorin MS SQL/MySQL dhe 56 përqind të cilët përdorin SQL. Çdo e treta kompani përdorë Access ose databaza të Oracle. Një hyrje e re në mes të databazave më të njohura është MongoDB, program i databazës NoSQL i përmendur nga 27 përqind e kompanive të teknologjisë si teknologji e databazës të cilën e përdorin në punë. Teknologjitë më së paku të përdorura janë IDMS (3%), Informix (3%), SAS (3%), dhe Sybase (3%).

TEKNOLOGJITË E DATABAZËS	PËRQINDJA E PËRDORUESVE
MS SQL Server	69%
mSQL/MySQL	61%
SQL	56%
Access	33%
Oracle	33%
MongoDB	28%
noSQL	19%
ODBC	17%
Apache	17%
CouchDB	11%
Redis	11%
Cassandra	11%
Progress	8%
DB2	6%
JDBC	6%
IDMS	3%
Informix	3%
SAS	3%
Sybase	3%
Tjetër	19%
Nuk përdorim asnjë	8%


**TABELA 2: ÇFARË TEKNOLOGJI TË DATABAZAVE PËRDORNI? (N=36)**

Më shumë se gjysmës (53%) e kompanive nuk i është kërkuar të sigurojnë ndonjë standard të kualitetit, 36 përqind të kompanive i është kërkuar të kenë ISO 9001 dhe 28 përqind standardin e cilësisë, ISO 27001.




**FIGURA 7: CILAT NGA STANDARDET E CILËSISË TË CEKURA MË POSHTË, I'U ËSHTË KËRKUAR KOMPANISË SUAJ QË T'I PËRMBAJË? (N=36)**

Ngjashëm me vitin e kaluar (50%) e kompanive të intervistuar nuk kanë asnjë certifikim të standardeve të cilësisë. Nga kompanitë të cilat janë certifikuar me standard të cilësisë, arsyeja kryesore për 26 përqind e tyre është përmisimi i proceseve brenda kompanisë, 12 përqind për të përmirësuar imazhin dhe reputacionin e kompanisë si dhe 12 përqind për arsye se iu është kërkuar nga klientët.




**FIGURA 8: CILA ËSHTË ARSYEJA KRYESORE QË KOMPANIA JUAJ KA MARRË NJË STANDARD TË CILËSISË? (N=36)**

Kur pyeten se cilat çertifikime teknike aplikohen për punëtorët e tyre, më e njohuara (58%) ishte Agile/Scrum, ndjekur nga PMP (36%) dhe çertifikime nga Microsoft (36%). Ky është një ndryshim i konsiderueshëm nga rezultatet e vitit të kaluar, ku të tre çertifikimet qëndruan mes 38 dhe 42 përqind. Një ndryshim tjetër është se 17 përqind e kompanive kanë punëtorë pa çertifikime teknike, krahasuar me 35 përqind nga viti i kaluar.




**FIGURA 9: CILAT ÇERTIFIKIME TË MËPOSHTME VLEJNË PËR PUNËTORËT TUAJ? (N=36)**

Përderisa 42 përqind e kompanive të TI deklaruan se tregjet eksportuese dhe vendore kanë rëndësi të njëjtë, këtë vit kompanitë anojnë më tepër nga njëra. Katërdhjetë e katër përqind përqendrohen në tregjet eksportuese, 42 përqind përqendrohen më tepër në Kosovë ndërsa 14 përqind thonë se të dyja tregjet janë të rëndësishme së njëjtë.



**FIGURA 10: CILI ËSHTË TREGU PRIMAR I KOMPANISË SUAJ?**

Sipas kompanive të TI në Kosovë, dy përparësitë kryesore krahasuese në tregun vendor janë kualiteti (92%) dhe njohuritë teknike (81%). Më shumë se gjysma e kompanive (56%) gjithashtu shohin çmimin si një nga përparësitë e tyre konkurruese.



**FIGURA 11: CILAT JANË AVANTAZHET KONKURRUESE THEMELORE TË KOMPANISË SUAJ NË KOSOVË? (N=36)**


Në krahasim me vendet e rajonit, palët e intervistuar besojnë se përparësia kryesore që ka Kosova është fuqia e re punëtore e saj – mbi të gjitha e aftë në gjuhët e huaja. Të rinjtë të cilët arsimohen në vendet e BE-së dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe diaspora e madhe konsiderohen një aset për Kosovën, pasi ata mund të shfrytëzojnë rrjetin e tyre profesional për të hapur rrugën në mënyrë që kompanitë e Kosovës të punojnë në tregjet ndërkombëtare. Një tjetër përparësi e kompanive në Kosovë është se ata janë më të gatshëm të integrojnë teknologjitë e reja, gjë që është shumë e rëndësishme kur konkurrojnë në tregjet e eksportit. Dy përfaqësuesit qeveritarë të intervistuar besojnë se politikat shtetërore janë një përparësi e rëndësishme për kompanitë e TI në Kosovë në krahasim me vendet e rajonit, veçanërisht në lidhje me stimujt e taksave që u ofrohen. Përveç një shkalle më të ulët të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) prej tetë për qind të produkteve të TIK, këtë vit, qeveria e Kosovës hoqi taksën mbi importet e shumicës së pajisjeve të teknologjisë informative.

Sa i përket pengesave, për të cilat Kosova është krahasuar me vendet e rajonit, palët e intervistuar besojnë se mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar është një mangësi e konsiderueshme. Sipas këtyre akterëve, institucionet arsimore duhet të investojnë më tepër në zhvillimin e fuqisë së re punëtore që është e kualifikuar për të përmbushur kërkesat e tregut të punës. Një përfaqësues i sektorit privat të TI në Kosovë gjithashtu pohoi se kostoja e fuqisë punëtore është më e lartë se në shumicën e vendeve të rajonit, gjë që është një pengesë për kompanitë e Kosovës kur konkurrojnë për projekte ndërkombëtare. Përsëri, çështja e liberalizimit të vizave konsiderohet nga të gjitha palët e intervistuar si një pengesë e madhe për kompanitë e TI në Kosovë në raport me vendet e tjera të rajonit.



Gjashtëdhjetë e një përqind e kompanive kryejnë shërbime për organizata/klientë ndërkombëtarë, gati 8 përqind më pak se vitin e kaluar kur ishte 69 përqind.

**FIGURA 12: A OFRON KOMPANIA JUAJ SHËRBIME PËR ORGANIZATA/KLIENTË NDËRKOMBËTAR NË KOSOVË? (N=35)**



61% e kompanive kryejnë shërbime për organizata dhe klientë ndërkombëtarë, një rënie prej 8% nga 69% në vitin e kaluar.

Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë që një kompani e zakonshme e TI në Kosovë vepron në tre sektorë (47%). Rreth 14 përqind veprojnë në më shumë se tre sektorë dhe 28 përqind e tyre veprojnë në vetëm një sektor.

Siç shihet në tabelën më poshtë, gati gjysma (47%) e kompanive veprojnë në sektorin e shërbimeve të TI dhe shërbime të jashtme (outsourcing), ndjekur nga Teknologji (33%) dhe sektori publik (E-Qeveria) (25%). Ndër sektorët më së paku të njohur për kompanitë e TI në Kosovë janë shërbimet komunale (3%), shërbimet (HR, kontabilitet, ligjore, etj) (6%) dhe patundshmëri (8%).




SEKTORËT VEPRUES NË KOSOVË	PËRQINDJA
Shërbime dhe IT Outsourcing	47%
Teknologji	33%
Sektor publik (E-qeveri)	25%
Shërbime financiare	22%
Marketing, Komunikim, Media dhe Publikim	19%
Telekomunikacion (Wireless and Mobil)	19%
Edukim (E-learning)	17%
Organizata joqeveritare (OJQ)	17%
Shërbime shëndetsore	11%
Prodhimtari, distribuim, shitje me pakicë	11%
Telematikë	11%
Tregti, Transportim dhe Logjistikë	11%
Automobilistikë	8%
Siguri	8%
Lojëra dhe argëtim	8%
Aplikimi dhe automatizimi industrial	8%
Patundshmëri	8%
Shërbime (burime njerëzore, kontabilitet, ligje)	6%
Shërbime komunale	3%
Nuk e di	6%
Tjetër	11%

**TABLE 3 NË CILËT SEKTORË OPERON KOMPANIA JUAJ NË KOSOVË? (N=36)**

# EKSPORTI I SHËRBIMEVE DHE PRODUKTEVE TË TI

Përqindja e kompanive që eksportojnë shërbimet dhe/apo produktet e tyre është rritur dukshëm nga 58 përqind në vitin e kaluar në 74 përqind këtë vit.


**FIGURA 13: A NDËRMERR KOMPANIA JUAJ AKTIVITETE EKSPORTUESE? (N=35)**



74 përqind e kompanive të TI në Kosovë eksportojnë shërbimet apo produktet e tyre, ngritur për 16 përqind nga viti 2017.


Në bazë të llojit të biznesit apo organizatës me të cilat kompanitë punojnë në tregjet eksportuese, 38 përqind thanë se punojnë me kompani ndërkombëtare, 34 përqind punojnë me tregje vendore dhe ndërkombëtare njëkohësisht ndërsa 21 përqind thanë se punojnë me kompani vendore në tregjet e eksportit.

**FIGURA 14: ME ÇFARË LLOJI TË BIZNESEVE APO ORGANIZATAVE PUNON KOMPANIA JUAJ, BRENDA TREGUT EKSPORTUES? (N=29)**






Shtetet me tregjet me potencialin më të lartë për eksport, cilësohen Gjermania (44%), Amerika Veriore (42%) dhe Zvicra (24%). Në anën tjetër, rajonet e cilësuara me më së paku potencial eksportues janë Azia Lindore (52%), Lindja e mesme dhe Afrika (42%).



**FIGURA 15: JU LUTEM VLERËSONI TREGJET POTENCIALE PËR EKSPORT, TË LISTUARA MË POSHTË: (N=36)**


Palët e interesit të intervistuar shohin potencialin më të madh për të eksportuar shërbimet dhe produktet e TI-së në vendet gjermano-folëse të BE-së dhe në Skandinavi. Ata të gjithë ndajnë mendimin se ekziston mungesa e profesionistëve të TI në këto tregje, e cila mund të plotësohet pjesërisht nga kompanitë e TI në Kosovë. Sipas tyre, Kosova ka dy përparësi kryesore në këtë drejtim, pasi shumë profesionistë të rinj flasin gjuhët e këtyre vendeve si dhe Kosova është në të njëjtën zone kohore si Skandinavia dhe vendet gjermano-folëse të BE-së. Palët e intervistuar gjithashtu vlerësuan potencialin e tregjeve amerikane dhe kanadeze si premtuese, duke pasur parasysh numrin e lartë të profesionistëve të rinj në Kosovë të cilët njohin gjuhën angleze. Vështirësia kryesore në këto dy tregje është ndryshimi i madh në zonat kohore. Në përgjithësi, palët e intervistuar besojnë se pengesa më e madhe në eksportimin e shërbimeve të TI mbetet numri i ulët i profesionistëve të kualifikuar në këtë fushë. Ata besojnë se me edukimin dhe trajnimin e duhur, rinia e vendit mund ta bëjë Kosovën një vend destinacion të nevojave për TI, për klientët në BE dhe Amerikës së Veriut.

Në këtë kuptim, nëntë nga 10 bizneset e intervistuar të TI besojnë se cilësia është një nga avantazhet kryesore konkurruese në tregjet ndërkombëtare. Pas cilësisë pasojnë njohuritë teknike (83%) dhe çmimi (76%).




**FIGURA 16: CILAT JANË AVANTAZHET THEMELORE TË KOMPANISË SUAJ NË TREGJET NDËRKOMBËTARE? (N=29)**

Njohja e gjuhëve të huaja cilësohet si përparësi kryesore në tregjet ndërkombëtare nga më shumë se gjysma e kompanive (52%). Sikur në vitin e kaluar, gjuhët e huaja më të njohurat nga kompanitë e TI në Kosovë janë anglishtja (97%), gjermanishtja (61%), dhe turqishtja (47%).



**FIGURE 17: CILAT NGA GJUHËT E PËRMENDURA MË POSHTË NJIHEN NGA PUNONJËSIT E JUJAJ? (N=36)**

Gjatë përfshirjes në aktivitete eksportuese, dy të tretat e kompanive të TI angazhohen në eksport drejtpërdrejtë nga vend i tyre tek klienti jashtë vendit, dhe 37 përqind e tyre shërbejnë si filiale. Puna si filiale/degë zyrtare në tregun e synuar (37%) është fenomen më i zakonshëm se vitin e kaluar (19%).



**FIGURE 18: SI E ZHVILLONI BIZNESIN NË TREGJE EKSPORTUESE? (N=30)**

Kërkesat për viza janë pengesa e vetme më e madhe në bërjen e biznesit në tregjet e eksportit sipas kompanive të intervistuar. Dy të tretat (68%) e kompanive vlerësojnë çështjen e vizave si jashtëzakonisht shumë problematike dhe një tjetër 11 përqind e vlerësojnë atë si shumë problematike. Mungesa e kontakteve të biznesit në tregjet e synuara (61%) dhe vështirësitë në gjetjen e partnerëve të duhur të biznesit (61%) janë gjithashtu pengesa të rëndësishme për kompanitë e TI në Kosovë. Nga ana tjetër, pengesat kulturore dhe gjuhësore (11%), standardet teknike dhe kërkesat (19%) dhe kosto eksportuese (24%) konsideroheshin më pak problematike sa i përket eksportit të shërbimeve dhe produkteve.

Kërkesat për viza (68%), mungesa e kontakteve në tregjet e synuara (61%) dhe vështirësitë në gjetjen e partnerëve të duhur të biznesit (61%) janë pengesat më të mëdha në të bërit biznes në tregjet eksportuese.




FIGURA 19: JU LUTEM VLERËSONI SFIDAT E MËPOSHTME NË BIZNES ME TREGJE EKSPORTUESE

Mungesa e profesionistëve të kualifikuar në TI dhe çështja e liberalizimit të vizave konsiderohen edhe nga akterët e intervistuar si dy sfidat më të mëdha me të cilat përballen kompanitë vendore në eksportimin e shërbimeve dhe produkteve të tyre. Njëri nga të intervistuarit nga sektori privat beson se mungesa e profesionistëve të kualifikuar është problem i dyfishtë, pasi që për kompanitë jo vetëm që e bën më të vështirë ofrimin e shërbimeve cilësore në tregun e eksportit, por gjithashtu rrit koston e tyre pasi ata duhet të paguajnë profesionistë të kualifikuar më shumë sesa që paguhen në vendet e rajonit.

Përfaqësuesit e sektorit privat diskutuan gjithashtu rreh politikave të vendit në promovimin e zhvillimit të sektorit të IT në Kosovë. Ata deklaruan se janë pjesërisht të kënaqur në këtë drejtim.

Përderisa të gjithë pajtohen se strategjia e TI-së, e zhvilluar në koordinim me sektorin privat dhe joqeveritarë, është një dokument i ngurtë që mund të ndihmojë zhvillimin e sektorit të TI në mënyrë të konsiderueshme, ata janë të mendimit se zbatimi i kësaj strategjie ka qenë shumë i ngadalshëm. Pavarësisht nga stimujt e taksave për produktet e TI, sipas tyre, sektori po zhvillohet dhe ndryshon vazhdimisht dhe akterët shtetërorë duhet të bëjnë më shumë për të hartuar politikat e duhura dhe për të krijuar mekanizma për zbatimin e menjëhershëm të këtyre politikave.


Megjithatë, shumica e palëve të intervistuar u pajtuan se qeveria e sheh atë si një nga sektorët më strategjik për zhvillimin e vendit dhe me themelimin e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, është bërë një punë e konsiderueshme në mbështetje të promovimit të kompanive të TI, si ato ekzistuese ashtu edhe ato të reja – start-ups.



# PERFORMANCA FINANCIARE

Siç shihet nga grafi më poshtë, sektori i TI në Kosovë ka pasur rritje të jashtëzakonshme për një vit të vetëm sa i përket të ardhurave vjetore. Për vitin 2017, kompanitë e TI kanë raportuar të hyra mesatare prej €435,990, përdërisa të hyrat mesatare për një kompani në sektor pritet të dyfishohen në €912,045 deri në fund të vitit 2018.

**FIGURE 20: CILAT JANË TË ARDHURAT TUAJA VJETORE (NË EURO)?**



Të ardhurat mesatare të kompanive të TIK pritet të dyfishohen këtë vit. Kompanitë e TIK kanë raportuar të ardhura mesatare prej €435,990 në vitin 2017, ndërsa në 2018 pritet që të ardhurat mesatare të jenë €912,045.

Penetrimi në tregjet e eksportit dhe forca e re punëtore konsiderohen si dy faktorët kryesorë që kanë ndihmuar kompanitë e TI në Kosovë të jenë të suksesshme. Përveç kësaj, disa nga palët e intervistuar e përmendën investimin në infrastrukturën e TI si një faktor i suksesit të kompanive të TI në Kosovë.

Nga grafi i mëposhtëm mund të shihet se ekziston një trend në rritje të eksportit në sektorin e TI në Kosovë. Eksporti total si përqindje e të ardhurave totale është rritur nga 52 për qind në 2016 në 64 përqind në 2018. Një trend i ngjashëm ka ndjekur eksportin në BE si një përqindje e të ardhurave totale. Në vitin 2016, eksportet në BE ishin 24 përqind, ndërsa në vitin 2018 ato u rritën në 30 përqind.




FIGURA 21: SA ISHTE EKSPORTI NË VITIN...? (N=33)

Puna e gjeneruar nga aktivitetet eksportuese pritet të jetë përgjegjëse për 64 përqind e të hyrave të kompanive të TI në vitin 2018, 12% më shumë se në 2016.

Ngjashëm me vitin e kaluar, kompanitë e TI raportuan se në tregjet eksportuese gjithashtu angazhohen më së shumti në sektorin e shërbimeve të TI dhe shërbimeve të jashtme (outsourcing) (56%) dhe teknologji (41%). Sektorët më së paku të njohur në tregjet eksportuese janë mbrojtja (4%) dhe patundshmëritë (4%).

SEKTORËT E PËRFSHIRË NË TREGJE EKSPORTUESE	PËRQINDJA
Shërbime dhe IT outsource	56%
Teknologji	41%
Shërbime financiare	22%
Marketing, Komunikim, Media dhe Publikim	22%
Organizata joqeveritare (OJQ)	19%
Prodhimtari, distribuim, shitje me pakicë	15%
Aplikimi dhe automatizimi industrial	15%
Aplikimi dhe automatizimi industrial	11%
Shërbime (burime njerëzore, kontabilitet, ligje)	11%
Tregti, Transportim dhe Logjistikë	11%
Automobilistikë	7%
Edukim (E-learning)	7%
Lojëra dhe argëtim	7%
Shërbime shëndetsore	7%
Sektor publik (E-qeveri)	7%
Turizëm dhe Hospitalitet	7%
Shërbime komunale	7%
Mbrojtje	4%
Patundshmëri	4%
Tjetër	7%

**TABELA 4: NË CILIN NGA SEKTORËT E MËPOSHTËM JENI TË ANGAZHUAR AKTUALISHT, NË TREGJE EKSPORTUESE?**

Sa i takon produkteve dhe shërbimeve të TI të ofruara në tregjet horizontale në vend, 38 për qind e kompanive ofrojnë Zhvillim të Përshtatshëm, 25 për qind ofrojnë Optimizim i Proceseve të Biznesit, 25 për qind ofrojnë E-Commerce dhe 25 për qind ofrojnë Konsulencë në TI. Shërbimi më pak i njohur është Tools/COTS, ofruar nga vetëm 3 përqind e kompanive. Për në tregjet horizontale në eksport, 70 për qind e kompanive ofrojnë Dizajn dhe Zhvillim të Web-it dhe 30 përqind ofrojnë Optimizim i Proceseve të Biznesit. Produktet dhe shërbimet më pak të njohura janë Inxhinieria dhe Zhvillimi Embedded (4%), Prodhimi i Medias së Re (Multimedia/Web animacione) (4%), Mirëmbajtja e Produkteve, Mbështetja dhe Përshtatshmëria (4%).




	TREGU VENDOR	TREGU EKSPORTUESE	DALLIMI MES TREGUT VENDOR DHE EKSPORTUES
Intelegjenca e biznesit/magazinimi i të dhënave	13%	19%	<b>-6%</b>
Optimizimi i procesit biznesor	25%	30%	<b>-5%</b>
Siguria e biznesit	16%	11%	<b>5%</b>
Zhvillimi softuerik (Custom development)/Outsourcing	38%	70%	<b>-33%</b>
Menaxhimi i konsumatorëve (CRM)	19%	15%	<b>4%</b>
Menaxhimi i dokumenteve	19%	7%	<b>11%</b>
E-commerce	25%	22%	<b>3%</b>
Inxhinieria dhe zhvillimi	6%	4%	<b>3%</b>
Planifikimi i burimeve sipërmarrëse (ERP)/Rrjeti i furnizimit	16%	19%	<b>-3%</b>
IT Konsulencë	25%	26%	<b>-1%</b>
Menaxhimi i projekteve për IT	16%	15%	<b>1%</b>
Knowledge Management / Operations	0%	7%	<b>-7%</b>
Mobile Solutions	22%	26%	<b>-4%</b>
Aplikacionet e navigimit	9%	15%	<b>-5%</b>
Prodhime të reja mediale (Multimedia/Animacionet)	6%	4%	<b>3%</b>
Mirëmbajtja e produkteve, Mbështetja dhe përshtatja	19%	4%	<b>15%</b>
Tools/COTS	3%	0%	<b>3%</b>
Dizajn dhe zhvillim i Webit	16%	37%	<b>-21%</b>
Siguria e kualitetit softuerik	0%	19%	<b>-19%</b>
Tjetër	16%	7%	<b>8%</b>

**TABELA 5: NE CILAT TREGJE HORIZONTALE I OFRONI PRODUKTET DHE/APO SHËRBIMET E MËPOSHTME TË IT? (N=36)**

# BURIMET NJERËZORE

Siç shihet nga grafi më poshtë, ekziston një trend rritës i numrit të punëtorëve gjatë viteve. Ky numër është rritur nga mesatarja prej 13 punëtorëve në vitin 2016, 16 në 2017 e deri në një mesatare prej 21 punëtorë për kompani, në vitin 2018.


**FIGURA 22: JU LUTEM NA TREGONI NUMRIN E PUNËTORËVE DHE BASHKËPUNËTORËVE (NËSE KENI PASUR) PËR VITET NË VIJIM. (N=29)**




Numri mesatar i punëtorëve është rritur nga 13 në vitin 2016 në 21 në 2018. Më shumë se gjysma e kompanive kanë normë të qarkullimit të punëtorëve 10 deri 25 përqind, pëderisa në vitin 2017, 77% e kompanive thanë që kjo normë ishte më pak se 10 përqind.

Për shumicën (53%) të kompanive TI, norma e qarkullimit të punëtorëve është 10-25%. Përveç kësaj, 11 përqind e kompanive të TI kanë një normë qarkullimi prej më shumë se 25%. Ky fenomen është shqetësues, sidomos duke pasur parasysh se në vitin 2017 shumica dërrmuese (77%) e kompanive të intervistuar të TI raportuan një shkallë qarkullimi të punëtorëve me më pak se 10%.

Megjithatë, për shumicën (56%) e kompanive nevojiten më pak se tre muaj për të zëvendësuar punonjësit ekzistues, për dallim nga 14 për qind që kanë nevojë për më shumë se gjashtë muaj për të gjetur zëvendësime.




**FIGURA 23: SA ËSHTË PËRQINDJA E NDËRRIMIT TË PUNONJËSVE TUAJ (TURNOVER RATE)?**



**FIGURE 24: SA KOHË JU DUHET PËR TË ZËVENDËSUAR PUNËTORËT QË E LËNË PUNËN?**

Gjetjet nga hulumtimi zbulojnë se dy pozitat më të paguara në sektorin e TI në Kosovë janë Menaxher i Zhvillimit të Biznesit (€1,091) dhe Zhvilluesit (€923). Të gjitha profesionet pa dallim në sektorin e TI kanë pasur rritje në paga prej vitit 2016 deri në vitin 2018.


Kthyer në përqindje, Menaxher i Zhvillimit të Biznesit (9%), Zhvilluesit (8%) dhe Administratorët e Databazës (8%) kanë pasur rritjen më të madhe në pagat mujore nga viti 2017 deri në vitin 2018.



**FIGURA 25: SA KANË QENË TË ARDHURAT MUJORE MESATARE(SIPAS KONTRATËS SË PUNËS), PËR POZITAT E MËPOSHTME? (N=36)**


Prirja e rritjes së numrit të punëtorëve dhe pagave në sektorin e TI pritet të vazhdojë vitin e ardhshëm. Pothuajse çdo e katërta kompani pret të ketë 50 përqind më shumë të punësuar vitin e ardhshëm, 42 përqind besojnë se do të rrisin numrin e punëtorëve për 25 përqind dhe 28 përqind mendojnë se numri i të punësuarve do të rritet me 10 përqind vitin e ardhshëm. Asnjë nga kompanitë nuk pret rënie në numrin e të punësuarve, dhe vetëm tetë përqind mendojnë se do të kenë të njëjtin numër të punëtorëve vitin e ardhshëm.

Përveç kësaj, shumica e kompanive të intervistuar (55%) besojnë se do të ketë një rritje prej 10 përqind në pagat e specialistëve të TI dhe një tjetër 35 përqind besojnë se specialistët e TI do të përfitojnë në rritjen e pagave prej 25 përqind ose më shumë. Pritjet janë pak më pak optimiste për profilet e tjera brenda industrisë, pasi 29 përqind e firmave besojnë se nuk do të ketë ndryshime në pagat e këtyre profileve vitin e ardhshëm, krahasuar me vetëm 10 përqind që besojnë se e njëjta do të ndodhë me specialistët e TI.




**FIGURA 26: SI PRITNI KËTO NDRYSHIME NË VITIN E ARDHSHËM? (N=36)**


Kompanitë e intervistuar u kërkuan të shpjegonin se si rrethanat aktuale ndikojnë në zhvillimin e bizneseve të tyre. Duke pasur parasysh faktorët ndikues negativ, 50 përqind e kompanive thanë se situata ekonomike kombëtare ndikon në biznesin e tyre, ndjekur nga tregu i burimeve njerëzore (46%) dhe konkurrenca e intensifikuar (42%). Nga ana tjetër, situata ekonomike globale u konsiderua pozitive në 22 përqind të rasteve.



**FIGURA 27: DUKE I KONSIDERUAR RRETHANAT AKTUALE, CILI ËSHTË NDIKIMI I FAKTORËVE NË VIJIM, NË ZHVILLIMIN E BIZNESIT TUAJ? (N=36)**



**FIGURA 28: A PO NDIKON IKJA E TRURIT (BRAIN DRAIN), NË BIZNESIN TUAJ? (N=36)**



**FIGURA 29: A PËRBALLET KOSOVA ME MUNGESË TË FUQISË PUNËTORE TË KUALIFIKUAR? (N=36)**

Shumica (78%) thanë se ikja e trurit (brain drain) po ndikon në biznesin e tyre. Përveç kësaj, shumica dërrmuese (92%) e të intervistuarve thanë që shteti po përballet me deficit të fuqisë së aftë dhe kualifikuar punëtore.

Intervistat e thelluara me palët e interesit gjithashtu zbuluan një pakënaqësi të përgjithshme me arsimin e ofruar nga institucionet arsimore në Kosovë në shkencat kompjuterike. Përfaqësuesit e sektorit privat deklaruan se të gjithë të diplomuarit e rinj që ata punësojnë duhet të trajnohen brenda kompanisë, pasi aftësitë e zhvilluara në shkollë nuk korrespondojnë me aftësitë e kërkuara në tregun e punës. Sipas tyre dhe përfaqësuesve e akterëve qeveritarë dhe joqeveritarë, kurrikula e arsimit për programet e shkencave kompjuterike duhet të ndryshojë në mënyrë të qëndrueshme. Të gjithë besojnë se për të zhvilluar profesionistë të rinj të kualifikuar, këto programe duhet të kthejnë fokusin e tyre nga teoria në praktikë dhe të rishikojnë kurrikulat e tyre për të plotësuar nevojat e tregut.

Përfaqësuesit e ministrive pohuan gjithashtu se arsimi formal në shkencat kompjuterike në Kosovë duhet të pësojë ndryshime të rëndësishme. Përfaqësuesi i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë tregon se është paraqitur një kërkesë zyrtare për rishikimin e kurrikulave të ofruara nga universitetet publike në Kosovë. Sipas përfaqësuesit, kurrikula e re duhet të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat dhe STIKK.

Rexhep Mala 28A,  
10000 Prishtinë, Kosovë  
+383 38 77 11 80 ext. 501  
info@stikk.org

STIKK ANËTAR I ARTË



WWW.STIKK.ORG